



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK



KOMISIONI I EKONOMISE FINANCE BUXHETIT MBIKQYRJES FINANCIARE
PLANIFIKIMIT TE ZHVILLIMIT STRATEGJIK

Nr. 98 Prot.

Fushe-Arrez, me 27.03.2026

PER KESHILLIN E BASHKISE

FUSHE-ARREZ

Relacion i Komisionit te Ekonomise Finance Buxhetit Mbiqyrjes Financiare Planifikimit te Zhvillimit Strategjik mbi shqyrtimin e projektvendimit për një ndryshim në VKB nr.8, datë 27.02.2026, “Për miratimin e nivelit të pagave të administratës së Bashkisë Fushë-Arrëz, Njësi Administrative, Institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara për vitin 2026”, (Punonjësit e arsimit bazë, Kopsht, QKF)”.

Ne zbatim te ligjit 139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”, i ndryshuar, u mblodh sot, me 27.03.2026, Komisioni i Ekonomise Finances Buxhetit dhe Mbiqyrjes Financiare. E pranishme ishte edhe Pergjegjesja e Zyres se Burimeve Njerezore, Zj.Fationa Selimaj, e cila dha shpjegime per projektin qe do te shqyrtohet ne kete mbledhje. Anëtarët e Komisionit janë njohur me projektin përmes materialit shkresor i cili gjendet edhe në faqen zyrtare web të Bashkisë Fushë-Arrëz.

Pergjegjesja e Zyres se Burimeve Njerezore, Zj.Fationa Selimaj, shpjegon se Bashkia Fushë Arrëz në kuader te zbatimit te akteve ligjore dhe nënligjore te ndryshuara në lidhje me nivelin e pagave per te gjitha kategorite e punonjesve dhe nepunësve në Bashkine Fushe-Arrëz dhe Institucioneve ne vartesi te saj, paraqet këtë relacion per here te dyte, brenda pak muajsh.

Bashkia Fushe Arrëz paraqiti këto ndryshime;

Bashkia Fushë-Arrëz paraqiti këto ndryshime:

Kopshti i Fëmijëve Fushë-Arrëz:

1. Drejtor Kopshti me ushqim 82,000 lekë, Lidhja 3
2. Edukatore në Kopshtin e Fëmijëve 61,000 lekë, Lidhja 3

Qendra Kulturore e Fëmijëve Fushë-Arrëz (QKF):

1. Drejtor i Qendrës Kulturore të Fëmijëve 102,000 lekë, Lidhja 3
2. Përgjegjës sektori në Qendrën Kulturore të Fëmijëve 76,000 lekë, Lidhja 3
3. Metodist në Qendrën Kulturore të Fëmijëve 63,000 lekë, Lidhja 3

Shtesa për vjetërsi në punë jepet në masën:

1. 0,6% pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e para (1–10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

2. 0,8% pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e dyta (11–20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

3. 1% pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e treta (21–30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit.

Për efekt të llogaritjes së shtesës së vjetërsisë, “vite pune” do të konsiderohet vjetërsia e përgjithshme në punë, e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi apo, në mungesë të librezës së punës, me çdo dokument tjetër ligjor të lëshuar nga organet kompetente përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi, me përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak të detyrueshëm, viteve të shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudhës së trajtimit me pagesë papunësie.

Shtesa për vjetërsi në punë jepet në masën 1% pagesë bazë minimale dhe për klasë, por jo më shumë se 25 vjet. Për llogaritjen e kësaj shume njihet vjetërsia e përgjithshme në punë.

Perjashtohen nga kjo llogaritje vitet e sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e arsimit dhe periudha e trajtimit me pagesë papunësie.

Për keto ndryshime janë përdorur burime financiare nga transfertat specifike, transfertat e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta për vitin 2026.

Sa më sipër kërkojmë nga ana juaj miratimin e këtij Projektvendimi.

Pasi u njohën me materialin, anëtarët e komisionit me shumicë votash, ranë dakort me projektin e paraqitur duke e derguar atë për miratim në mbledhjen e datës 30.03.2026 të Këshillit Bashkiak, duke kërkuar edhe mendime dhe propozime të tjera të anetareve të keshillit.

PER KOMISIONIN

Valentina Lleshaj

Bejana Marku

Franz Soda

Zef Ceku

Valentin Dogi